

Transformimi i Gjelbër i Ndërmarrjeve
Private Në Kosovë (GPEK)

FONDI PËR INOVACION

THIRRJE PËR PROPOZIME

**ÇFARË KONSIDEROHET
INOVACION PËR FONDIN PËR
INOVACION**

ÇFARË KONSIDEROHET INOVACION PËR FONDIN PËR INOVACION

Fondi për Inovacion zbatohet në kuadër të projektit **Transformimi i Gjelbër i Ndërmarrjeve Private (NVM) në Kosovë (GPEK)**, i cili synon të mbështesë ndërmarrjet private në adoptimin dhe zgjerimin e inovacioneve të gjelbra që kontribuojnë në efikasitetin e burimeve, reduktimin e ndikimit mjedisor, rritjen e konkurrueshmërisë dhe transformimin më të gjerë të gjelbër të sektorit privat në Kosovë.

Përkufizimi i Inovacionit

Për qëllimet e Fondit për Inovacion, inovacioni nënkupton prezantimin, përshtatjen ose zgjerimin e produkteve, shërbimeve, teknologjive, proceseve të prodhimit ose modeleve të biznesit që janë të reja ose të përmirësuara ndjeshëm në tregun e Kosovës dhe që kanë potencial të gjenerojnë ndikim të matshëm mjedisor dhe/ose ndikim më të gjerë në treg.

Inovacioni nuk nënkupton domosdoshmërisht një teknologji ose zgjidhje që është e re në nivel global. Një zgjidhje mund të konsiderohet inovative nëse është aplikuar me sukses diku tjetër, por po prezantohet, përshtatet ose përmirësohet ndjeshëm për tregun e Kosovës.

Çfarë Mund të Konsiderohet Inovacion?

Inovacioni mund të përfshijë, por nuk kufizohet në:

- Aplikimin për herë të parë në Kosovë të teknologjive të dëshmuara të gjelbra ose zgjidhjeve të ekonomisë qarkore;
- Përmirësime të konsiderueshme të proceseve ekzistuese të prodhimit që rrisin efikasitetin e burimeve ose energjisë, reduktojnë mbetjet ose emetimet, apo përmirësojnë performancën mjedisore;
- Modele të reja të gjelbra të biznesit, si produkti-si-shërbim, skemat e riciklimit dhe ripërdorimit, simbioza industriale ose modele të tjera të biznesit të ekonomisë qarkore;
- Përshtatjen ose zgjerimin e zgjidhjeve të testuara që kanë dëshmuar potencial mjedisor dhe komercial;
- Kombinime të reja ose të përmirësuara ndjeshëm të teknologjive, proceseve, shërbimeve ose modeleve të biznesit që adresojnë një nevojë specifike të tregut.

Nivelet Indikative të Inovacionit

INOVACION I ULËT

Përmirësime graduale të produkteve, proceseve ose praktikave ekzistuese, me potencial të kufizuar për ndikim më të gjerë në treg ose në nivel sistemik.

INOVACION I MESËM

Përshtatja ose prezantimi i teknologjive, proceseve, shërbimeve ose modeleve të reja të biznesit në tregun e Kosovës, me potencial të konsiderueshëm për përmirësime mjedisore, ulje të kostove dhe/ose rritje të konkurrueshmërisë.

INOVACION I LARTË

Zgjidhje që janë ndër të parat e llojit të tyre në tregun e Kosovës ose që përfaqësojnë një avancim të konsiderueshëm teknologjik apo të modelit të biznesit, me potencial të lartë për përsëritje, zgjerim dhe ndikim më të gjerë në treg ose në nivel sistemik.

Çfarë Do të Thotë Kjo për Aplikantët?

Një projekt nuk ka nevojë të zhvillojë një teknologji të re në nivel global për t'u kualifikuar si inovativ.

Ajo që ka rëndësi është nëse zgjidhja e propozuar sjell vlerë të re ose të përmirësuar ndjeshëm në tregun e Kosovës, adreson një sfidë relevante të transformimit të gjelbër dhe demonstroi potencial të besueshëm për ndikim mjedisor, qëndrueshmëri komerciale dhe përhapje më të gjerë.

Fondi për Inovacion do t'u japë përparësi projekteve me inovacion të mesëm dhe të lartë, veçanërisht atyre me potencial për të ndikuar në sjelljen më të gjerë të tregut, zinxhirët e vlerës ose transformimin e gjelbër në nivel sektorial.